Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**05.10.2023**	**17.10.2023**	**2023/0755**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2023, **OE "ENGINEERING RK SH.P.K.& Gashi ING SHPK"**-ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0755**, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Varna SH.P.K&Bujar Shabani B.I& Konstruktori ING.1969"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndertimi i Bulevardit te Qytetit ne Kamenice-Punet e mbetura-Ritenderim 2"** me nr. të prokurimit: **"KM653-23-8454-5-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E KAMENICËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratsës: punë, vlera e parashikuar e kontratsë: **460,192.00** €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0755 i dt:02.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1
NENI 7
NENI 59
NENI 69
NENI 70

Pase qasjes ne dokumentacion e keti tenderi kemi verejten se grupi i OE ne koncersium i shpallun fitues eshte i pa pergjegjshem ne shume pika.

Pretendimi 1. Gjate krijimit të grupit të OE konform nenit 87, paragrfi 2, nen paragrafi 2.8 te ligjit 04/L042 per prokurimi publik i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin 04/L-237 Ligji 05/L-068 dhe Ligjjin 05L/092 te RROUP të rregullave per Grupin e Operatorve Ekonomike te percaktuar me nin 71 i LPP-se dhe neni 26 i rregullores Nr. 001/2022, ne raste se OE vendosin te tenderojn ne grup Grupi i OE duhet te dorezoj se bashku me tenderin e tyre mareveshjen per themelimin e grupit ne paragrafet 2 dhe 3 te nenit 71 te LPP-se si dhe ne FTD (Fleta e te dhenave te tenderit) te dosjes se tenderit kerkohen tri deklarata qe duhet te plotesohen nga Grupi i OE si ne vijim:

a. **Nje deklarat e qarte ku gjithe antaret e grupit jane bashkarisht** dhe individualsiht pergjegjes per permbajtjen e grupit te tenderit
b. **Nje deklarat te nenshkruar** nga secili antare duke konfirmuar pjesmarrjen e tyre ne grupe se ata nuk jane duke marre pjes ne menyre individuale apo ne ndonje grup tjeter qe marrin pjese ne proceduren e njejt te prokurimit
c. **Nje deklara te nenshkruar nga gjith antaret e grupit te cilet e autorizojn partnerin kryesore** per te vepruar ne emer te grupit.

Grupi i OE i shpallun fitues NUK i ka plotesuar keto kerkese siq duhet.

Pretendimi 2. Grupi i OE lideri i grupit Varna Sh.P.K. nuk e ka asnje pune te ngjashme dhe nuk permbush kushtin per 51% pune te ngjashme

Pretendimi 3. ISO e kerkuara i ka ta te prezentuar vetem lideri Varna Sh.P.K. ndersa antaret e grupit nuk i kane, konform rregullores A01/2022 neni 26.6 ku gjithe antaret veq e veq duhet te plotesojn kushtin per standardin e cilese dhe ne kete pike Grupip i OE ka deshtuar te plotesoj

Prentendimi 4. Ingjinjeri i ndertimit z. Feriz Terstena i njejti ka maredhnje pune me Insticione publike (profesore ne shkollen e mesme teknike ne Gjilan) me norme te plote 40 ore ne jave dhe te njejtin ky grup i OE e ka prezentuar si ing i hidros me kontrate te plote ne 40 ore ne jave. Ne baze te ligjit te punes nje person jurudik nuk munde te jete me orar te plote ne te njejten kohe ne dy pune. Primare

Prentendimi 5. Ne njoftimin per kontrate eshte kerkuar vetem nje gjeodete ndersa Grupi i OE ka prezentuar 2 ingjinjer te gjeodezise, gjeodeti i prezentuar me kontrate ka diplome ne Universitetin e Sarajeves por nuk e ka paraqit nostrefikimn e diplomes i cili ka qen kusht ne DT, ingjinjer tjeter i

prezentuar me kontrate me OE ne koncersium Bageri Company nuk ploteson kushtin 5 vite pervoj pas diplomimit me cka nenkupton se ky kusht nuk eshte plotesuar nga Grupi i OE ne koncersium.

Konstatimi1. per OE nuk qendrojn nga AK-ja dhe kete e kemi deshmuar me argumente ne kerkesen per ri-shqyrtim mirpo AK-ja nuk i ka marre parasyshe,
Konstatimi1. Plani Dinamik- Edhe ne kerkesen per sqarim permese deklarates se Grupit te OE kemi deklaraur se ka qen leshim teknik (devijim i vogel) nga ana e ingjinjerit dhe permes kesaj deklarate jemi zotuar se mbrenda 120 diteve do ta permbyllim projektin, me kerkesen per ri-shqyrtim kemi dorezuar edhe planin dinamk te ri me 120 kalendarike, edhe pse ju si AK nuk e keni kerkuar ne kerkesen per sqarim te tenderit planin e ri dinamik por vetem keni kerkaur deklarim
Konstatimi 2. Sa i perket kontratave/ referncave te natyres se njejt ne si koncersium kemi ofruar mbi 50 kontrata te natyres se njejt te cilate jane te ngarkuare ne e-prokurim,
Konstatimit 3. Menagjeri i projektit nuk ka te menagjuar projekte te natyrese se ngjashme kjo nuk qendron siq e kemi argumentar edhe ne kerkesen per ri-shikim z. Emin Rexhepi ka refernca te kesaj natyre psh. Ne projektin Renovimi i shtepise se kultures ne Viti ku menagjer ka qene z. Rexhepi eshte ndertu platoja prej 560m2 nga graniti natyral me trashesi 3cm, pastaj Nderimi i shkolles ne lagjen Malesia Kamenic, platoja para shkolle, dhe gjitha shkollat tjera ku ka qen menagjer z. Rexhepi secila nga to ka pase kubeza te betoni, dhe ne nuk kemi leshu refernce per secilin aktivitet te kontrates por refernca eshte leshuar me emer te projekti qe nenkupton edhe punet e cekura me larte dhe si i till ky konstatim nuk qendron dhe z. Rexhepi ka pervoj te madhe dhe i ploteson te gjitha kerkesat e DT.
Konstatimi 4. Nuk qendron aresyetimi i AK-se se nuk kemi vendime per stafin e angazhuar sepse te gjithe jane me mareveshje ne emer te projektit dhe te noterizuar ne prani te kompanise dhe ingjinjerave. Dhe nuk munde te nxerrim vendim kur te njejten kohe kemi mareveshje angazhimi me emer projekti. Ky kusht eshte i plotesuar nga ana e jone.

Konstatimi 5. Ing i gjeodezie i cili ka mbaruar studimet per master ne Tirane, i kemi dorezuar ne kerkesen per ri-shqyrtim kopjen e mareveshjes Kosov – Shqiper e vitit 2021 me te cilen njihen diplomat ne dy shtete respektive.
Konstatimit 6. I kemi sqauar AK-se se cmimet per fontanat jane te liferuar kohe me pare ne depot e liderit Gashi ing, dhe oferta jone si tersi eshte vetem 8% e parashikuar nga AK-ja.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Në fund kërkojmë nga OSHP që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE Engineering RK Sh.P.K. dhe Gashi Ing Sh.P.K.
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në
RI-VLERSIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme; Ndërtim të hapësirave publike, shesheve - ku përfshihen hapësira publike, gjelbërim dhe ndricim në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 600,000.00 €	**Dëshmia 1 Lista e Kontratave me të dhënat e detajuara sipas formës së Aneksit 6. Të bashkangjiten referencat ose pranimet teknike apo raportet e punëve të përfunduara. AK ka të drejtën për verifikimin dhe shikimin për cdo dokument që dorzohet nga OE**
Kërkesa 2 OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon 2.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master (menaxher i projektit), me min 5 vite përvoj pune pas diplomimit. Inxhinieri në fjalë duhet të ketë menaxhuar kontrata të natyrës së njejtë. 2.2 Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose mastër (udhëheqësi i punishtes) me min 5 vite përvoj punë pas diplomimit. Inxhinieri në fjalë të dëshmohet se ka menaxhuar projekte në lëmin e infrastrukturës publike. 2.3 Një (1) Inxhinier të diplomuar ose mastër të Elektroteknikës. Me min 5 vite përvoj puneangazhime profesionale pas diplomimit. 2.4 Një (1) Inxhinier të diplomuar ose mastër të Hidroteknikës. Me min. 5 vite përvoj puneangazhime profesionale pas diplomimit. 2.5 Inxhinier i diplomuar ose mastër i Gjeodezisë i Licencuar (me licencë valide). Me min 5 vite përvojë pune-angazhime profesionale pas diplomimit. 2.6 Lista e punëtorëve e dorzuar nga OE, min.20 punëtor të angazhuar për këtë projekt.	**Dëshmia 2 Për gjitha pikat e kërkuara, duhen të dorzohen Diploma e noterizuar, kontrata e punës e noterizuar me vërtetim nënshkrimi ose të ketë parakontratë noteriale me vërtetim nënshkrimi ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt. Vendimet për caktimin e detyrave për secilin të nënshkruar nga OE dhe inxhinieri në fjalë. CV-ja e nënshkruar ku paraqitet sakt përvoja e punës. Referenca apo raportedëshmi tjera ku dëshmohet qartë përvoja e kërkuar e punës. Për secilën pikë, nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar conform ligjeve në fuqi të R.Kosovës. Stafi I kërkuar duhet të jetë I angazhuar vazhdimisht në punishte.Për 20 punëtoret lista e nëshkruar dhe vulosur .**
Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.	**Dëshmia 3 e kërkuar dokumentare Librezat valide të qarkullimit, DUD-at, Faturat etj. OE duhet të dorozj marrëveshje për shfrytëzim për cdo mjetë që nuk e posedon në pronësi. AK ka të drejtën e verifikimit dhe shikimit për cdo makineri të dorzuar nga OE.**
Kërkesa 4. OE duhet të ofrojë planin dinamik të detajuar për realizimin e punëve të specifikuar në ditë kalendarike për secilin pozicion të përshkruar në paramasë dhe parallogari.	**Dëshmia 4 Planit dinamik duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.**
Kërkesa 5 OE të jetë i certifikuar me ISO standartet nderkombetare për ndertim i. ISO 9001 per Menaxhimin e Cilësisë, ii. ISO 14001 për Menaxhim të Mjedisit iii. ISO 45001 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë	**Dëshmia 5 – Kopjet e certifikatave ISO me validitet**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë-Punët e mbetura-Ritenderim 2

Nr. i prokurimit[2]	KM653-23-8454-521

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[3]
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik „VARNA SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.; " Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k.,	460,087.00€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik ENGINEERING RK SH.P.K.; GASHI ING SH.P.K rruga Hoxhe Jonuzi nr 86, viti	423,235.00€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Kamenicë për **Ndërtimi i Bulevardit të Qytetit në Kamenicë-Punët e mbetura-Ritenderim 2** shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik „VARNA SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.; " Konstruktori Ing.1969 Sh.p.k., në vlerë totale të ofertës **460,087.00€**

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë A.K në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L237,ligjin Nr.05/L068 dhe ligjin Nr. 05/L-09 ,në afat prej 5 ditëve pas publikimit të këtij njoftimi.

Data: 12.03.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: URIM THAÇI

Nënshkrimi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ENGINEERING RK SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit: **"Ndertimi i Bulevardit te Qytetit ne Kamenice-Punet e mbetura-Ritenderim 2"** me nr. të prokurimit: **"KM653-23-8454-5-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E KAMENICËS, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 09.08.2023, me procedurë të hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 21.08.2023, si dhe vendimi mbi rekomandimin është publikuar me datë 12.09.2023.**

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret, si dhe AK nuk ka vlerësuar ofertat konform nenit 1, 7, 59, 69, 70 të LPP-së.

I njëjti është i eliminuar nga AK me arsyetimin:

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik ENGINEERING RK SH.P.K.; GASHI ING SH.P.K nuk ka referenca te natyres se njejte . refernacat e prezantuar nuk jane natyre e njejte . Menaxheri I projektit (ne referencen e leshuar nuk ka projekte te natyres se ngjashme te menaxhuar sipas kerkeses).Per gjithe stafin mungojne vendimet mbi caktimin e detyrave nga punekryresi dhe ing Gjeodeti eshte I diplomuar ne shqiperi (diploma e panostrifikuar). Plani dinamik (ne sqarimet e kerkuar aper plamnin dinamik eshte kerkuar qe te sqarohet pse nuk eshte nenshkruar dhe vulosur dhe afati I implementimit te projektti) Ne arsyetimin e kompanise vetem eshte thene qe eshte bere gabim teknik ndersa nuk eshte dorezuar plani I detajuar sipas kerkeses ne Nj.K dhe D.T

Per planin dinamik jane kerkuar sqarime shtese dy operatoret ekonomik. Grup i Operatorëve Ekonomik ENGINEERING RK SH.P.K.; GASHI ING SH.P.K ka paraqitur vetem nje deklarate ku thuhet qe eshte bere nja gabim teknik gjate perpilimit te planit dinamik dhe nuk ka bashkangjitur panin dinamik te specifikuar per secilin pozicion te pershkruar ne paramase ne pajtim me kohen prej 120 diteve kalendarike.

Ju keni çmime abnormalisht te uleta ne pozicionin 2.13 Furnizimi dhe montimi i Fontanave Freskuese të cilat do të shërbejn për freskimin e njerzve,ato do të jenë me sistem automatik me dy forma rrethore me sistem të përbashket. Forma dhe dimensionet sipas Projektit. Per kete pozicion O.E ka vendosur çmimin 500Euro per cope a ne realitet duke llogaritur qmimet e tregut para shpalljes se procedures kemi verejtur se komplet instalimi I Nje fontane kushton rreth 10,000€ . Per kete pozicion jane planifikuar 2 fontana qe O.E ka planifikuar ti perfundoje me 1,000.00€ . Ne nuk kemi kerkuar informate per çmime abnormalishte te uleta pasi qe ka munges te dokumentacionit te kapacaiteti teknik sipas nenin 68 dhe 69.

Përgjigje në pretendimet e OE ankuesit kundër OE të rekomanduarit:

OE ankuesi pretendon se OE I rekomanduar nuk I posedon deklaratat nën betim në ofertë. Ekspertja Shqyrtuese pas verifikimit të ofertës së OE të rekomanduarit sqaron se, janë të bashkangjitura tri deklaratat veç e veç, marrëveshjen mbi konzorciumin, liderin, si dhe autorizimin, dhe si e tillë **pretendimi nuk gjendet e bazuar.**

Pretendimin e dytë, lidhur me liderin e grupin Varna SHPK për të cilin pretendon se nuk I posedon 51% të kontratave të përfunduara, ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet lista e kontratave, ndërsa kriteri 51% nuk është kërkuar nga AK në DT, dhe si e tillë **pretendimi nuk gjendet I bazuar.**

Pretendimi i tretë, lidhur me Iso standardet, ku OE ankuesi pretendon se OE I rekomanduar nuk i posedojnë konform rregullores 02/2022 neni 26.6, ekspertja shqyrtuese sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet ISO çertifikata e liderit, mirëpo AK mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me çertifikatat ISO, dhe si e tillë **pretendimi gjendet pjesërishtë I bazuar.**

Pretendimi i katërt, lidhur me inxhinierin e ndërtimit Feriz Tërstena për të cilin pretendohet se është në marrëdhënie pune në një shkollë me orar 40 orë, ekspertja shqyrtuese sa I përket këtij pretendimi mendon se është diskrecion I AK-së që ti hulumtoj gjatë procesit të rivlerësimit, **pretendim pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i pestë, lidhur me Gjeodetin e licencuar, ku OE ankuesi pretendon se OE I rekomanduar ka bashkangjitur në ofertë dy Gjeodetë, të cilët njeri nuk posedon përvojën 5 vjeçare ndërsa tjetri nuk e posedon diplomën e nostrifikuar, ekspertja shqyrtuese sa i përket pretendimit sqaron se, inxhinieri i gjeodezisë z.Musa Ahmetaj

posedon licencën e cila mendoj se mund ta plotësoj kriterin, dhe si e tillë **pretendimi nuk gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimet e OE ankuesit kundër eliminimit nga AK:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankuesit sqaron se,në ofertën e OE ankuesit sa i përket planit dinamik, i njëjti ka të bashkangjitur një plan dinamik me 150 ditë të cilën pastaj me datë 03.09.2023 ka sqaruar që është gabim teknik në ditën të cilën e ka përmirësuar por jo edhe planin ne letër, fillimisht AK mendoj se nuk është dashur të kërkoj sqarime lidhur me planin dinamik as për OE ankuesin e as për OE të rekomanduarin, mirëpo përderisa AK ka pranuar sqarimet e OE të rekomanduarit lidhur me planin dinamik atëherë edhe OE ankuesin është dashur ta trajtoj njëjtë, andaj **pretendimi gjendet i bazuar.**

Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit lidhur me referencat për kryerjen e punëve sqaron se, në ofertën e OE ankuesit gjendet lista me projektet e përfunduara, të cilat janë natyra të ngjashme, për faktin se janë të gjitha ndërtime, disa ndërtime të lagjeve, rrugëve, kalldrëme etj, ku mendoj se AK ka mundur ti verifikoj paramasat e tyre, se a kanë hapësira përcjellëse gjelbëruese, me trotuare (kubëza betoni) etj.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme; Ndërtim të hapësirave publike, shesheve - ku përfshihen hapësira publike, gjelbërim dhe ndricim në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 600,000.00 €	**Dëshmia 1 Lista e Kontratave me të dhënat e detajuara sipas formës së Aneksit 6. Të bashkangjiten referencat ose pranimet teknike apo raportet e punëve të përfunduara. AK ka të drejtën për verifikimin dhe shikimin për cdo dokument që dorzohet nga OE**

Tutje, lidhur me Menaxherin e projektit ku AK ka eliminuar me arsyetimin se nuk posedon referenca, në ofertën e të njëjtit gjenden referencat për punët e kryera të natyrës së ngjashme, mirëpo jo të natyrës së njëjte ashtu siq kërkohet në DT nga AK, për të cilën AK mund ta analizoj dhe trajtoj konform nenit 59.4 të LPP-së.

Kërkesa 2 OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon 2.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master (menaxher i projektit), me min 5 vite përvoj pune pas diplomimit. Inxhinieri në fjalë duhet të ketë menaxhuar kontrata të natyrës së njejtë. 2.2 Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose mastër (udhëheqësi i punishtes) me min 5 vite përvoj punë pas diplomimit. Inxhinieri në fjalë të dëshmohet se ka menaxhuar projekte në lëmin e infrastrukturës publike. 2.3 Një (1) Inxhinier të	**Dëshmia 2 Për gjitha pikat e kërkuara, duhen të dorzohen Diploma e noterizuar, kontrata e punës e noterizuar me vërtetim nënshkrimi ose të ketë parakontratë noteriale me vërtetim nënshkrimi ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt. Vendimet për caktimin e detyrave për secilin të nënshkruar nga OE dhe inxhinieri në fjalë. CV-ja e nënshkruar ku paraqitet sakt përvoja e punës. Referenca apo raportedëshmi tjera ku dëshmohet qartë përvoja e kërkuar e punës. Për secilën pikë,**

Sa i përket Gjeodetit, në ofertë është e bashkangjitur licenca valid për Gjeodetin, e cila mendoj se ka mundur të merret si e mirëqenë.

Kurse, lidhur me çmimet jo normalisht ulëta që ka potencuar AK, është në diskrecion të AK-së që të vlerësoj se nëse është e nevojshme të kërkohet sqarime.

Si përfundim, pretendimet e OE ankuesit kundër AK-së dhe OE të rekomanduarit

janë pjesërishtë të qëndrueshme, për të cilat mendoj se AK duhet ta kthej lëndën në rivlerësim, duke ekzaminuar dhe krahasuar ofertat konform LPP-së, udhëzuesit 01/2023 të PP-së si dhe rregullores 01/2022 për PP.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E KAMENICËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ENGINEERING RK SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica